



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Akademia e Shkencave  
KRYESIA

Nr. \_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_ 2020

**Rregullore e veprimtarisë botuese  
të Akademisë së Shkencave**

**Neni 1**

**Përparësitë e ASHSH në veprimtarinë botuese**

*ASHSH ka si përparësi themelore botimin e veprave madhore të zgjedhura e përmbledhëse të akademikëve apo figurave më të rëndësishme të dijes e kulturës shqiptare, që kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore shpirtërore e materiale të popullit shqiptar, si gjuha, historia, tradita, identiteti, si dhe me pasuritë dhe burimet natyrore të vendit.*

*Në veprimtarinë botuese ASHSH nxit e mbështet me përparësi botimin e fjalorëve normativë të gjuhës shqipe dhe projektet me karakter institucional, si Enciklopedia Shqiptare, Historia e popullit shqiptar, botimet antologjike.*

*Origjina dhe historia e zhvillimit të gjuhës, qytetërimit, kulturës, historisë dhe identitetit kombëtar; përrurimi i vlerave identifikuese të popullit shqiptar dhe i personaliteteve të historisë dhe qytetërimit të tij në botime shqip e në gjuhë të huaj; vlerësimi dhe aktivizimi i burimeve të zhvillimit, përbëjnë interesime shkencore konstante të ASHSH.*

## Neni 2

### Enti botues i ASHSH

ASHSH ka *entitë e vet botues*, që përgatit dhe publikon veprat e miratuara për botim, me autorë anëtarë të saj dhe/ose personalitete të dijes nga radhët e bashkëpunëtorëve të saj.

Botimet e ASHSH mbajnë në ballinë logon dhe emrin e institucionit dhe kanë një formatim të jashtëm identifikues.

Pranë ASHSH funksionojnë redaksitë shkencore të botimeve periodike.

Botimet e ASHSH pajisen me ISBN dhe periodikët me ISSN. Redaksitë e botimeve periodike mbajnë lidhje me institucionet e indeksimit ndërkombëtar dhe kanë për detyrë rritjen e cilësisë shkencore përmes përfshirjes së tyre në listat e njohura të renditjes shkencore në botë.

## Neni 3

### Këshilli i botimeve

Për realizimin e projekteve vjetore të botimeve pranë ASHSH funksionon *këshilli botues*, me anëtarë të brendshëm dhe të jashtëm, përfaqësues të institucioneve kryesore shkencore akademike dhe universitare.

Kryetari i ASHSH është kryetar i këshillit botues.

Këshilli përbëhet nga 11-13 anëtarë: kryetari, zëvendëskryetari, dy anëtarë të zgjedhur nga seksionet përkatës, dy-tre përfaqësues të komisioneve të përhershme, tre-katër anëtarë përfaqësues të institucioneve të arsimit të lartë, një përfaqësues nga Ministria e Kulturës (*Qendra Kombëtare e Librit*) dhe një përfaqësues nga Ministria e Diasporës.

## Neni 4

### Vepra shkencore

Një vepër konsiderohet shkencore dhe botohet nga ASHSH në përputhje me përparësitë e saj strategjike të përshkruara në *Nenin 1* të kësaj rregullorje, si dhe me mundësitë buxhetore nëse plotëson kushtet e mëposhtme:

- Është paraqitje e argumentuar dhe sistematike e rezultateve origjinale të një pune kërkimore shkencore;
- Është e pajisur me referenca bibliografike dhe / ose dokumentare;
- Përshkruan rezultatet shkencore në një formë të përshtatshme për verifikim dhe / ose ripërdorim në kërkim të mëtejshëm shkencor;

- I është nënshtruar një procedure të formalizuar *ex et ante* (*paraprakisht dhe pas botimit*) dhe të bërë publike të recensionimit.

Veprës shkencore i sigurohet shpërndarje e konsiderueshme, me qëllim që jetë e mundur njohja dhe shqyrtimi kritik i saj prej bashkësisë shkencore. Për këtë qëllim ajo duhet:

- Të depozitohet në bibliotekat universitare shqiptare dhe në bibliotekat universitare jashtë vendit, ose të jetë i këshillueshëm në distancë;

- Të jetë shkruar me gjuhë të përshtatshme për bashkësinë shkencore përkatëse, të kuptueshme për shumicën e studiuesve të interesuar (gjuha duhet të jetë standarde, e qartë, korrekte, univoke).

Termat që përdoren në këtë rregullore për *veprën shkencore* janë në pajtim me kriteret e pranuar ndërkombëtarisht për botimet shkencore në dokumentin e njohur si *Manuali Frascati*.

#### Neni 5 Redaksitë

Botimet periodike (revistë, buletin) janë përgjegjësi shkencore e seksioneve. Pranë tyre ngrihen redaksitë e përhershme. Anëtarë të redaksive janë nga radhët e akademikëve të fushës dhe përfaqësues të institucioneve kërkimore. Kryeredaktor i periodikut është kryetari i seksionit. Çdo anëtar i Akademisë ka të drejtën e shqyrtimit me përparësi të punimeve të veta shkencore për t'u botuar në periodikët e ASHSH. Kriteret, afatet dhe procedurat e pranimit të artikujve shkencorë për botim në periodikët e ASHSH përcaktohen në rregulloren e redaksisë.

Këshilli i botimeve propozon një rregullore teknike dhe përbërjen e vet, duke ruajtur përpjesëtime të balancuara të anëtarësisë së brendshme dhe të jashtme. Rregullorja dhe përbërja miratohen dhe shpallen nga Kryesia.

Redaksi të posaçme krijohen për botimin e akteve të konferencave dhe të tubimeve të tjera shkencore.

#### Neni 6 Revistat shkencore

Konsiderohet *revistë shkencore* periodiku që:

- Plotëson kriteret e përgjithshme si në *Nenin 1* të kësaj rregullorje;
- Siguron procedurë të formalizuar të recensionimit të artikujve, e cila duhet të jetë publike *ex et ante* (*paraprakisht dhe pas botimit*), të garantuar

nga një bord shkencor, anëtarët e të cilit i përkasin kryesisht të njëjtit komunitet kërkimor;

- Siguron anonimitetin e recensionuesve që bëjnë vlerësimin paraprak të punimeve për pranimin e tyre për botim;

- Siguron periodicitet të rregullt;

- Respekton rreptësisht standardet ndërkombëtare të katalogimit dhe indeksimit shkencor (titull, abstrakt dhe fjalët kyçe në gjuhën angleze).

Përmbushja e këtyre kriterëve verifikohet në vijimësi. Përveç tyre dhe në koherencë me to redaksitë përgjegjëse respektojnë edhe kriteret specifike sipas tipologjisë së periodikut.

Enti botues dhe redaksitë inkurajohen për indeksimin shkencor të tyre në listat me njohje ndërkombëtare (*Scopus, Thomson etj.*).

#### Neni 7

##### Botimet përuruese

ASHSH bën botime përuruese dhe popullarizuese për pasqyrimin e veprimtarive të veta (konferenca, seminare, projekte). Në kuadër të programit të edukimit në shkencë ajo boton edhe përmbledhje studimesh me karakter njohës për arritjet shkencore. Botimet përuruese dhe ato popullarizuese bëhen me vendim të Kryesisë.

#### Neni 8

##### Etika në botime

Pranimi i kotributeve shkencore bëhet në përputhje me praktikat më të mira të etikës së botimit, duke respektuar rreptësisht kërkesat në lidhje me autorësinë dhe ndalimet për dorëzimin e dyfishtë, plagjiaturën, manipulimin e figurave dhe konfliktin e interesit.

Etika e botimeve shkencore të ASHSH mbështetet në *Kodin europian të sjelljes për integritet në kërkimin shkencor.*

#### Neni 9

##### Parandalimi i plagjiaturës

Plagjiatura është e papranueshme dhe e dënueshme. Plagjiatura përfshin, por nuk kufizohet vetëm me:

- Kopjimin e tekstit të materialit nga burime të tjera;

- Kopjimin e ideve, imazheve ose të dhënave nga burime të tjera;

- Ripërdorimin e tekstit nga botime të mëparshme personale;
- Përdorimin e një ideje nga një burim tjetër me gjuhë të modifikuar.

Konsiderohet plagjiaturë edhe: 1. Tjetërsimi i autorësisë, përdorimi i pacituar i një materiali origjinal, i botuar a i pabotuar qoftë; 2. Tjetërsimi i autorësisë përmes perifrazimit, fshehjes formale, përkthimit të lirë, që rezulton shkelje në sasi e cilësi e parimit *fair use* (përdorimit të arsyeshëm) të origjinalit të tjetrit; 3. Në çdo rast që teksti i huajtur zotëron mbi punën e autorit.

Teksti i kopjuar drejtpërsëdrejti nga një burim tjetër paraqitet dukshëm, ndërmjet thonjzash ose me shkrim korsiv, duke cituar burimin origjinal në gjithë treguesit, në atë shkallë që mundësojnë verifikim.

Përdorimi pa citim i skicës së një studimi, i strukturës së veprës së re, bartur a frymëzuar nga vepra të mëparshme vetjake, është autoplagjiaturë.

Dorëshkrimi nuk pranohet nëse plagjiatura zbulohet gjatë recensionimit.

Nëse plagjiatura zbulohet pas botimit, ASHSH ruan të drejtën njoftimit publik. ASHSH informon zyrtarisht institucionet ku autorët punojnë për plagjiaturën e zbuluar para ose pas botimit.

## Neni 10 Manipulimi i imazhit

**Manipulimi i ilustrimeve është i papranueshëm.**

Imazhet nuk mund të manipulohen a të rregullohen në atë mënyrë që çon në keqinterpretim të informacionit që përcjell imazhi origjinal.

Manipulimi i imazhit përfshin, por nuk kufizohet vetëm me:

- Përdorimin e imazhit, duke përmirësuar, zhvendosur apo duke hequr karakteristika të veçanta brenda tij;
- Grupimin e pashenjuar me dicitura të imazheve, që për ndryshe duhej të paraqiteshin veçmas;
- Përshtatjen a rregullimin e dritës, kontrastit apo ekuilibrit të ngjyrës për të errësuar, shmangur apo keqinterpretuar ndonjë informacion.

Nuk përbën manipulim rasti i qortimit të imazhit të burimit të përdorur nga një autor i dytë për ilustrim, nëse ai vetë përmban fshehje të pjesshme, shtesa a modifikime, që kanë shmangur përmbajtjen e tij të vërtetë.

Në qoftë se manipulimi shmangës i imazhit verifikohet gjatë procesit të recensionimit, ASHSH i kërkon autorit të dhënat burimore. Dorëshkrimi mund të mos pranohet për botim nëse nga verifikimi nuk krijohet siguri.

Nëse manipulimi shmangës i imazhit vihet re pas botimit, ASHSH ruan të drejtën e njoftimit korrigjues. ASHSH informon institucionet ku autori është i punësuar rreth manipulimit.

#### Neni 11 Konflikti i interesit

ASHSH përcakton si konflikt interesi çdo gjë që do të ndërhynte ose do të mund të perceptohej si ndërhyrje në paraqitjen e plotë dhe objektive në recensionim, në vendimmarrjen editoriale a botimin e një dorëshkrimi.

Konflikti i interesit mund të jetë financiar, profesional apo personal, dhe mund të lindë përkundrejt një individi apo organizate.

Individët që kanë të bëjnë me vlerësimin e dorëshkrimit të dorëzuar për botim (përveç autorëve): anëtarët e redaksisë, redaktorët shkencorë, oponentët dhe të tjerë, duhet të deklarohen paraprakisht për marrëdhëniet me artikullshkruesin në lidhje me konfliktin e mundshëm interesi.

#### Neni 12 Verifikimi i autorësisë

Autorësia e një vepre (punimi, artikulli) pretendohet nga subjekti i paraqitur me këtë cilësi nëse ai vetë:

- Ka konceptuar dhe projektuar veprën, mbështetur në të dhëna që i koleksionuar prej burimesh bibliografike e arkivore dhe në metodologji shkencore, si dhe i ka interpretuar dhe analizuar ato;
- Ka hartuar vetë lëndën shkencore ose e ka rishikuar atë në mënyrë kritike, referuar treguesve të rëndësishëm të dijes intelektuale të fushës;
- Ka dhënë pëlqimin përfundimtar për variantin e dorëzuar për botim.

Autori merr individualisht përgjegjësinë publike për karakterin shkencor të lëndës. Kontribuues të tjerë të mundshëm për kryerjen e punimit, që nuk kualifikohen si autorë, përmenden në një falënderim të veçantë.

Kur punën e ka kryer një grup studiuesish apo qendër studimore, lista e autorëve duhet të përfshijë gjithë individët, kontributet e të cilëve plotësojnë kriteret e përcaktuara më lart, si dhe emrin e grupit.

#### Neni 13 Pranimi i punimeve shkencore

Dosja e një punimi shkencor që dorëzohet për botim pranë entit botues të ASHSH duhet të përmbajë:

- Kërkesën drejtuar këshillit të botimeve ose redaksisë përkatëse;
- Studimin shkencor të shtypur në format A4 dhe të numerizuar në formatim PDF, në letër dhe në CD. Për botimin në periodikët shkencorë autori paraqet edhe përkthimin në gjuhën angleze;
- Deklaratën e autorësisë dhe të origjinalitetit;
- Ilustrimet në regjistrim të numerizuar me rezolucion të lartë.

Pranimi bëhet në zyrën e protokollit para mbylljes së vitit kalendarik, bashkë me deklaratën me shkrim që punimi është i përfunduar dhe mund të kalojë menjëherë për shqyrtim e botim.

Dorëshkrimi i dorëzuar nuk mund të tërhiqet për të bërë ndryshime.

Dorëshkrimet nuk kthehen.

Autori deklaron me shkrim se studimi i tij, ose ndonjë studim i ngjashëm, nuk është duke u shqyrtuar ose nuk është pranuar diku tjetër për botim.

Recensionimi është proces që kryhet nga enti botues. Recensionuesve u kërkohet të shprehen edhe për mbivendosje mes aplikimeve të ngjashme.

#### Neni 14

##### Vendimmarrja për botim

Pas shqyrtimit të punimit shkencor dhe të dokumenteve të certifikimit këshilli i botimeve dhe redaksitë shprehen me vendim, që merret jo më vonë se në tremujorin e parë të vitit kalendarik. Pas kësaj nënshkruhet kontrata e botimit me autorin. Redaksitë marrin vendime dy herë në vit.

#### Neni 15

##### Ndalimet në lidhje me burimet e mbështetjes financiare

ASHSH nuk pranon artikuj ose monografi në të cilat ndonjë nga kostot e kërkimit a shpërblimit të autorit është financuar, tërësisht ose pjesërisht, nga një kompani prodhuese a tregtuese e duhanit, ose nga persona fizikë dhe juridikë që kanë probleme me zbatimin e ligjit.

#### Neni 16

##### Autori në vepër

Autor është çdo person fizik ose një grup personash fizikë, që krijojnë një vepër shkencore (monografi, përmbledhje studimesh, artikull, përgatitje botimesh kritike), produkt intelektual origjinal, pavarësisht nga forma

dhe mënyra e të shprehurit. Në mungesë të provave për të kundërtën, çdo individ ose grup individësh, emri i të cilit shfaqet mbi ballinën e një vepre, cilado qoftë mënyra e shfaqjes, prezumohet autor i veprës.

#### Neni 17

##### Kontrata e botimit

Pas miratimit nga këshilli i botimeve ose redaksia, autorit/autorëve u lind e drejta për nënshkrimin e kontratës së botimit dhe përfitimin e shpërblimit të punës krijuese dhe shkencore, referuar ligjit *Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera lidhura me to*.

Me kontratën e botimit autori pranon t'i njohë entit botues të drejtën e riprodhimit të veprës së tij nëpërmjet shtypshkrimit ose shumëfishimeve të tjera të ngjashme, si dhe të drejtën e shpërndarjes së tirazhit të veprës; ndërsa botuesi merr përsipër të publikojë veprën dhe t'i njohë autorit të drejtat për të cilat është rënë dakord, si dhe të kujdeset për shpërndarjen e suksesshme të tirazhit të saj dhe t'i sigurojë autorit informacion periodik për shpërndarjen. Në kushtet e kontratës së botimit parashihet kohëzgjatja e të drejtave të entit botues.

#### Neni 18

##### Shpërblimi i autorit/autorëve

Botimet e ASHSH nuk kanë qëllim të mirëfilltë fitimprurës. Impakti në dije dhe në jetën e shoqërisë janë misioni i tyre.

Në përmbushje të këtij misioni, ASHSH dhuron botimet e veta për bibliotekat universitare e publike, për akademitë bashkanëtare në të njëjtat organizata ndërkombëtare, për qendrat dhe katedrat e studimeve albanologjike në botë, për subjektet me interes arsimor e shkencor në diasporat shqiptare, si dhe për individë të shquar në studimet shqiptare.

Marrëdhëniet midis entit botues të ASHSH dhe autorëve rregullohen përmes një kontrate tip të negociueshme, që mban në konsideratë misionin dhe qëllimin e botimeve të saj.

Masa dhe format e shpërblimit të autorëve përcaktohen me marrëveshje, varësisht prej rëndësisë së studimit, individualitetit të autorit si faktor ndikues, të gjinisë dhe të llojit. Një nënkomision shkencor ngrihet dhe funksionon pranë këshillit të botimeve për vlerësimin financiar të të drejtave të autorit për çdo vepër të botuar prej saj.



Për veprat me bashkautor, marrëdhëniet mes bashkautorëve e shpërblimi i tyre përcaktohen me marrëveshje ndërmjet palëve, sipas Kodit Civil.

#### Neni 19

##### *Copyright-i i botuesit dhe i autorit*

Pas nënshkrimit të kontratës së botimit dhe shpërblimit të autorëve, ASHSH zotëron të drejtë ekskluzive sipas ligjit *Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me to*. E drejta e autorit lejon çdo përdorues të shkarkojë, të shtypë, të nxjerrë një ekstrakt, të ripërdorë dhe të arkivojë veprën e botuar në përputhje me tarifatat e parashikuara për sa kohë që përdoruesi e citon autorin dhe burimin e veprës sipas ligjit.

#### Neni 20

##### *Procedurat për recensionim*

Dorëshkrimet e dorëzuara për botim në ASHSH i nënshtrohen shqyrtimit të hollësishëm të recensionimit, sipas këtyre procedurave:

- Shqyrtimi fillestar i punimit, për të krijuar bindjen se vepra e propozuar u përgjigjet programeve të ASHSH në veprimtarinë botuese, bëhet nga sektori i botimeve dhe i bibliotekës, i cili vlerësimin e vet ia paraqet me shkrim këshillit të botimeve;
- Këshilli i botimeve cakton për çdo vepër minimalisht dy recensues; kur është e mundur njëri nga radhët e akademikëve dhe një i dytë nga radhët e studiuesve të fushës jashtë institucionit. Caktimi i më shumë se dy recensuesve për raste të veçanta vendoset nga këshilli i botimeve.
- Gjatë procesit të recensionimit ruhet ndërsjelltazi si fshehtësia e autorësisë së punimit, dhe ajo e autorësisë së recensionit.
- Recensuesi i propozon këshillit të botimeve një prej këtyre zgjidhjeve: a). Pranimin e dorëshkrimit për botim; b). Pranimin me një rishikim të lehtë; c). Rishikimin e thellë të punimit; ç). Refuzimin e kërkesës për botim.
- Recensionet i bëhen të njohura autorit të veprës.
- Mbi bazën e recensioneve këshilli i botimeve merr vendim për miratimin e botimit ose për kthimin e tij për rishikim, plotësim apo saktësim. Për një rishikim të lehtë apo të thelluar autorëve u vihen në dispozicion 10-45 ditë.
- Këto procedura zbatohen njëjloj edhe në rastet kur autori i financon vetë shpenzimet për botimin në Akademinë e Shkencave.

## Neni 21

Veprimtaria e redaksive shkencore të botimeve periodike të Akademisë së Shkencave (*Albanian Journal of Natural and Technical Sciences* dhe *Studia Albanica*) rregullohet sipas të njëjtave normave themelore të nenit 20. Për specifikat e tyre redaksitë mund të hartojnë dhe miratojnë rregullore të brendshme.

## Neni 22

### Njësimi teknik

Botimet e ASH kanë standard teknik të njësuar në paraqitjen formale. Njësimi teknik përfshin: formatin e ballinës, ngjyrat dhe shenjat identifikuese të saj; llojin dhe madhësinë e shkronjës së përdorur në titull dhe nëntitull, në emrin e autorit dhe të entit botues.

Njësimi teknik i brendshëm përfshin formatin e tekstit, madhësinë dhe tipin e shkronjës, ndërlinjat e bardhësitë.

Janë teknikisht të njësuar në paraqitjen e jashtme dhe në formatimin e brendshëm: *korpuset dhe kolanat e studimeve, monografitë, përmbledhjet e artikujve dhe të akteve të konferencave, revistat dhe buletinet, albumet dhe botimet e ilustruara, partiturat muzikore dhe materialet promovuese.*

Kodifikimi strukturor i punimit/artikullit; unifikimi i sistemit të citimit të *brendashkruar* e të *jashtëshkruar*; i mënyrës së hartimit të bibliografisë, shtojcave dhe treguesve; si dhe përdorimi i ilustrimeve, bëhet duke iu referuar njërit prej sistemeve të njohur ndërkombëtarë të referimit (*Harward Reference Style, Oxford Reference Style, Modern Language Association, Chicago Citation Format, American Psychological Association, Springer Endnote Style* ose ndonjë tjetër).

Këshilli i botimeve dhe redaksitë, pas zgjedhjes së sistemit të citimit, shpallin në faqen zyrtare të institucionit *guidën me instruksionet e detyrueshme* të paraqitjes formale të tekstit shkencor nga autorët.

Për njësimin e paraqitjes formale të jashtme sipas këtij neni ASHSH organizon një konkurs. Për njësimin teknik të brendshëm vendos vetë këshilli i botimeve. Për periodikët vendos redaksia.

**Neni 23**  
**Ankimimi**

Autorët mund të paraqesin ankesë me shkrim për refuzimin e materialit të tyre pranë këshillit të botimeve/redaksisë. Ankesa duhet të përmbajë arsyttime të detajuara të pretendimeve të tij, duke iu referuar pikë për pikë përgjigjeve të recensionuesve ose komenteve të redaktorit akademik.

**Neni 24**  
**Shfuqizime**

*Kriteret për botim, miratuar me Vendimin nr. 2, datë 1 korrik 2014 të Kryesisë së ASHSH, shfuqizohen.*

**Neni 25**  
**Hyrja në fuqi**

*Rregullorja e veprimtarisë botuese të Akademisë së Shkencave hyn në fuqi menjëherë.*

**Kryetari**

**AKADEMIK SKËNDER GJINUSHI**

**Kjo rregullore u miratua në parim me vendimin nr. 18, në mbledhjen e datës 21 shkurt 2020 të Asamblesë së ASHSH.**

## Shtojca 1

### Tipologjitë e botimit shkencor

Termat e pranuar në *Shtojcën 1* për nocionet e kërkimit shkencor bazë dhe të aplikuar (paragrafi 64); për aktivitetet që duhen përjashtuar nga nocionet e kërkimit dhe zhvillimit (paragrafi 66); në mënyrë që të bëhet qartazi dallimi i tyre nga aktiviteti i vërtetë shkencor, përdoren me të njëjtin kuptim si në *Manualin Frascati*, sipërcituar.

*Monografia* është *botim shkencor* nëse përmban në një vepër me strukturë të qendrushme dhe është një studim i thelluar, me risi, i karakterizuar nga qasjet kritike, realizuar nën përgjegjësinë shkencore të një ose më shumë autorëve.

*Vepra* e autorit është *botim shkencor* nëse përmban *vepra të plota* a *vepra të zgjedhura* të tij, kur autori është personalitet i trashëgimisë, dijes dhe kulturës tradicionale shqiptare, anëtar i Akademisë a bashkëpunëtor i saj, të botuara më parë ose jo, që i paraqiten lexuesit shkencor si seri përfaqësuese e produktit shkencor akademik.

*Përmbledhjet e shkrimeve* janë *botim shkencor* kur paraqesin rezultate të kërkimit shkencor në fusha të ndryshme, nga aspekte të ndryshme dhe në kohë të ndryshme, duke përfshirë rastin kur janë botuar shpërndarë në periudha dhe tribuna të shtypit shkencor. Këtu përfshihen edhe materialet e mbajtura në forumet shkencore të Akademisë.

*Trashëgimia kulturore e popullit shqiptar* është *botim shkencor* nëse paraqitet në formën e një serie të botimit kritik-shkencor të monumenteve të gjuhës, letërsisë dhe kulturës materiale të popullit shqiptar, pajisur me studim hyrës dhe aparat shkencor.

*Kontributi në një libër ose kapitull të librit* (në rastin e një vepre kolektive) konsiderohet *botim shkencor* nëse ka një autonomi konceptuale e mundësisht edhe editoriale dhe lidhet me emrin e një ose më shumë autorëve lehtas të identifikueshëm.

*Botimi kritik* konsiderohet *botim shkencor* në qoftë se është një vepër në të cilën teksti përbërës (*constitutio textus*) shoqërohet nga një aparat kritik, ku përfshihen burimet bibliografike dhe dokumentare të përdorura për rindërtimin e tekstit. Në këtë lloj botimi dhe me këto referenca

përfshihet edhe transkriptimi muzikor i pjesëve të ndryshme apo tingujve që më parë nuk janë muzikuar (shprehur në nota muzikore).

*Përkthimi i teksteve shkencore* konsiderohet *botim shkencor* në qoftë se u është nënshtruar ligjeve të hermeneutikës, karakterizuar nga një qasje kritike me aparat kritik-shkencor të përkthyesit.

*Kumtesat në një kuvend shkencor* (simpozium, konferencë, colloquium) konsiderohen *botim shkencor* nëse kanë qenë objekt i shqyrtimit dhe i pranimit paraprak nga një komitet a bord shkencor.

*Kontributet në vepra të natyrës leksikografike ose enciklopedike* konsiderohen *botim shkencor* nëse janë paraqitje sistematike dhe kritike e dijeve të specializuara për temën në fjalë, shprehur me prurje origjinale në *lemën* e fjalorit apo *zërin* e enciklopedisë; nëse është pjesë e një vepre me njohuri të sistemuara me interes shkencor dhe lidhet me emrin e një ose më shumë autorëve lehtas të identifikueshëm.

*Parathënia* (hyrje, pasthënie apo *excursus*) konsiderohet *botim shkencor* nëse ofron një analizë origjinale të temave, substrateve dhe gjuhëve të tekstit dhe ruan të njëjtën linjë interpretimi.

*Përgatitja për shtyp e një vepre* konsiderohet *botim shkencor* nëse përmban një angazhim të dukshëm për ideimin dhe bashkërendimin e materialit, shprehur së paku në një hyrje me karakter metodologjik.

*Komenti për vendimin gjyqësor* konsiderohet *botim shkencor* nëse paraqitet si një analizë kritike, e zgjeruar dhe e thelluar e temës-objekt të aktvendimit të komentuar.

*Komenti rreth ligjit* konsiderohet *botim shkencor* nëse është një studim eksegjetik i një teksti ligjor, i zgjeruar me një aparat kritik që dokumenton burimet juridike e doktrimore të analizës përkatëse.

*Recension* konsiderohet *botim shkencor* nëse paraqitet si një ese kritike e temave të veprës në shqyrtim dhe karakterizohet nga një analizë sistematike, inkuadruar në një kontekst kulturor.

*Publikimi i burimeve të pabotuara* konsiderohet *botim shkencor* nëse karakterizohet nga qasja kritike dhe shoqërohet nga një hyrje ose një shenjim të tipit arkivor / diplomatik.

*Botimi kritik rreth gërmimit* (arkeologjik) konsiderohet *botim shkencor* nëse paraqet rezultatet e një kërkimi të kryer mbi baza shkencore, me metoda dhe qëllime të specifikuara dhe është një analizë me shtrirje të konsiderueshme edhe për sa i përket cilësisë paraqitëse.

*Shenjimet shpjeguese për hartën gjeologjike apo tematike konsiderohen botim shkencor nëse paraqiten si një vepër e karakterizuar nga qasja kritike dhe si analizë me shtrirje të gjerë edhe për sa i përket cilësisë paraqitëse.*

*Bibliografia konsiderohet botim shkencor nëse është botuar si një vepër e pavarur dhe karakterizohet nga një qasje kritike dhe e arsyetuar, me synimin për të përpunuar dhe rindërtuar, edhe përmes shënimeve sqaruese, studimet e kryera në një temë të veçantë.*

*Konkordancat konsiderohen botim shkencor nëse janë paraqitje sistematike dhe kritike, si edhe në kontekst, i kuptimeve konceptuale që i referohen zërave dhe shprehjeve të një teksti dhe karakterizohet nga një metodologji e rreptë në prezantimin e rezultateve.*

*Manuali konsiderohet botim shkencor nëse ka karakterin e një vepre monografike dhe paraqet sintezën e përvojës kulturore të autorit në një fushë të veçantë të kërkimit.*

*Publikimi popullarizues ose që u referohet profesioneve (nëse nuk ka qenë subjekt i një rishikimi) konsiderohet botim shkencor në qoftë se paraqet sintezën e përvojës së autorit në një fushë të veçantë të kërkimit dhe shërben si një adaptim, kritik dhe i dokumentuar, i temave shkencore.*